

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 9 QERSHOR 2022

Prej kohësh në këtë parlament janë denoncuar bordet si institucione të së shkuarës sonë komuniste dhe sot një bastard i bllokmenëve hoxhistë e konfirmoi këtu krenarisht, se me këtë metodë komuniste ka gjetur shpëtimin e qytetarëve shqiptarë. Unë i kam denoncuar bordet, i denoncoj dhe do t'i denoncoj sa herë të dal në këtë platformë, si shushunja, të cilat po i pinë gjakun, po u boshatisin xhepat, po u nxijnë jetën qytetarëve, po i fusin në depresion me çmimet stratosferike sa askund tjetër në Europë dhe në botë në mënyrën më të pamëshirë vetëm e vetëm për të mbrojtur qeverinë dhe oligarkët e saj. Ai që ia mbathi, se nuk rri dot këtu (se edhe kjo zonja ka për mision të bëhet parzmore e tij, duke shkelur Rregulloren në çdo nen) tha se po bën heroizëm në energji.

More, zotëri,

Të dashur qytetarë,

Po ky vend nuk prodhon qoftë edhe 1 kilovat energji nga nafta, as nga gazi, të gjithë energjinë e kanë nga burimet natyrore ujore! Ky vend, në dallim nga Maqedonia e Veriut, prodhon 1 milion tonë naftë në vit, kurse nafta këtu është në çmimet më të larta sesa në Europë dhe në botë, kurse energjia këtu është jo në proporcion, por pa proporcion me çmimet më të larta në Europë. Në mënyrën më të papërgjegjshme deklarohet se biznesin e vogël e kemi me zero taksa, në një kohë kur vetëm energjia elektrike biznesit të vogël i merret dy herë më shumë se sa i merrej me taksat vite më parë. Ky zotëri ka humbur çdo sens realiteti.

Vjedhja e përditshme, e përorshme, e përnatshme duket se shërben si narkotik që të shkëput nga realiteti dhe bota përreth. Shkon në Ohër dhe shkelmon mbi jetën, vdekjen, sakrificat, gjakun e 12 mijë shqiptarëve në Kosovë, sikur është ky padroni i jetës së tyre! A e dëgjoni ju, apo jo, more zotërinj? A ju bën përshtypje ky? Ç'të drejtë ka ky të flasë në emër të të vdekurve në Kosovë? Çfarë të drejte ka Kryeministri i Shqipërisë në një akt të mirëfilltë çnjerëzor të

krahasojë viktimat e gjenocidit serb me viktimat e agresorit në Luftën e Dytë Botërore? Çfarë agresioni ka kryer ndonjëherë Kosova? Çfarë njeriu është ky, xhanëm? Ky bën gjithçka si skllav i Vuçiqit! Mirë ai që nuk ka ndjeshmëri, sepse është arkitekt i gjenocidit me doktrinën e tij, po ky çfarë ka?

Pse i kërkohet Kosovës të mbështesë Ballkanin e Hapur? Cili nga ju i ka harruar samitet e Novi Sadit dhe hartën që nxori ky me padronin e tij, e cila nuk përfshinte Kosovën, përkundrazi, e paraqiste pjesë të Jugosllavisë, pjesë të Serbisë, njëlloj siç u betua padroni i tij një javë më parë për garantimin e sovranitetit të saj? Qytetarë shqiptarë, a do të vazhdojmë ne të pranojmë një njeri si ky, i cili vetëm me vjedhjet, vjedhjet, vjedhjet e tij dhe të klikës së tij, ndikon dhe i rrit çmimet në stratosferë? A do të vazhdojmë ne ta pranojmë këtë njeri që ju mashtron nga mëngjesi deri në darkë? A do të vazhdojmë ne ta pranojmë këtë njeri që shkelmon mbi gjakun? Vetëm fëmijë, në Kosovë, të masakruar, të therur e të vrarë janë 1400. A ka fëmijë ky njeri? Çfarë ndjenjash ka? A është njeri ky njeri apo jo?

Moj zonjë, se je avokatja e tij më e zjarrtë dhe më e flaktë, saqë nuk na jep as fjalën për procedurë, na thuaj pak, çfarë ndjenjash ka ky? Thuajua qytetarëve shqiptarë! Folu! Janë 1400 fëmijë të vrarë në Kosovë, të therur, të djegur të gjallë. Ku e ka ky autoritetin të flasë, t'i krahasojë me viktimat e agresorëve në Luftën e Dytë Botërore? Le të flasin autoritetet e Kosovës, meqenëse nuk ndien asgjë për ta! Kur ndihesh vasal i verbër i barbarëve, të cilët i masakruan ata, pse përdhos parlamentin me qëllime të tilla? Kush të lejon ty të falësh gjakun e tyre? Çfarë je ti? Çfarë lidhjeje ke ti me ta? Janë 1400 fëmijë, shpirtrat e të cilëve kërkojnë drejtësi!

Paraardhësi yt, Enver Hoxha, është akuzuar pas Hitlerit për infanticid; diktatori i vetëm në Europë. Unë nuk them se i ke vrarë ti ata, por mungesa e ndjeshmërisë totale ndaj shpirtrave të 1400 fëmijëve të akuzon si një qenie të përçudnuar. Ik sa të duash, je i pashpresë. Ky ka gjetur si ilaç ikjen sapo unë marr fjalën, kurse për periudhën që më mohohet fjala ka parzmoren këtu mbrapa, që nuk pyet për Rregullore, por kjo nuk më pengon mua t'ia them që të gjitha në sy dhe do t'ia them shesh më shesh, e rrugë më rrugë. Shqipëria do të ngrihet e tëra në këmbë,

sepse nuk durohet më kjo që po ndodh. Gënjeni, mashtroni dhe vidhni në mënyrën më të paimagjinueshme.

Dje mediat paraqitën dokumente se vetëm me interesat e kredive që keni marrë keni vjedhur 130 milionë euro. Pse? Sepse nuk tenderoni kreditë me interesa të ulëta që japin donatorët bujarë, sepse ato nuk u jepen dot gjicëve dhe stërgjicëve, por jepen me tenderë të hapur dhe rregulla strikte. Ndaj, ju morët kredi tregtare, duke taksuar me 130 milionë euro më shumë interesa kredish qytetarët shqiptarë. Për sa i përket segmentit rrugor Kardhiq– Delvinë, ta mësojnë qytetarët shqiptarë se loti i parë prej 7 kilometrash është ndërtuar me 5 milionë euro ose 710 mijë euro për kilometër, kurse loti i dytë prej 5 kilometrash është ndërtuar me 22 milionë euro, gjashtë herë më shtrenjtë.

Xhepat tuaj nuk mbushen kurrë, sepse vidhni, vidhni dhe vetëm vidhni. Ajo rrugë me të cilën krenoheni sot duhet të përfundonte në vitin 2014, por ju po e përfundoni atë 8 vjet me vonesë, sepse vodhët, vodhët dhe vetëm vodhët.